



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Engroup" Sh.P.K. të datës 04.08.2023 kundër njoftimit kontratë të datës 28.04.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 02.05.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi dhe përmisimi i infrastrukturës së objekteve të KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-23-4220-5-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **MIRATOHET** si e bazuar pjesërisht kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Engroup" Sh.P.K. e datës 04.08.2023 kundër njoftimit kontratë të datës 28.04.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 02.05.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi dhe përmisimi i infrastrukturës së objekteve të KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-23-4220-5-1-1.
- II. **KONFIRMOHET** se autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës **DETYROHET** që të kthejë në rivlerësim aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të vendimit.
- III. **UDHËZOHET** komisioni për rivlerësim që me rastin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve të shqyrtoj nëse janë plotësuar kushtet për përfundimin e aktivitetit të prokurimit për shkak të pretendimeve ankimore të parashtruesit në kuptim të nenit 62 paragrafit 1 të LPP lidhur me nenin 43 paragrafin 43.5 të RRPP.
- IV. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Engroup" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- V. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "Engroup" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 04.08.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit kontratë të datës 28.04.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 02.05.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi dhe përmisimi i infrastrukturës së objekteve të KPSH" me nr. prokurimi 616-23-4220-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

**Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:**

- *“Qeshtja me me rendesi qe ne kemi verejtur ne dokumentacionin e kompanise te shpallur fituese, eshte qe Kompania ne fjale ka nderhyre ne Paramase, gje qe eshte e ndaluar sipas Ligjit te Prokurimit Publik”;*
- *“AK ka shpallur te suksesshem kompanin e cila ka qen me çmimin me te lire por, ne si OE kemi verejtjet tona pasiqe kompania e shpallur fituese eshte e denuar nga Gjykata pikerisht per qeshtje te Prokurimit Publik”.*

Për shkak të këtyre pretendimeve të cituara si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 56, 59, 60, 64, 65 dhe 69 të LPP. Përmes kërkesës për rishqyrtim është kërkuar që lënda të kthehet në rivlerësim.

**Lidhur me pretendimin kryesor ankimor të parashtruesit sipas të cilit tenderuesi i rekomanduar ka ndërhyrë në paramasë me rastin e tenderimit, paraprakisht duhet sqaruar se në formularin e paramasës që është publikuar në sistemin e-prokurimi në rubrikën me numër 4.6 dhe 4.7 nuk është përcaktuar fare sasia për të cilin tenderuesit duhet të ofertojnë çmimet e tyre. Sa i përket pretendimit ankimor, në ofertën e tenderuesit të rekomanduar është gjetur se çmimet e ofertuara për këto kategori janë përcaktuar për një (1) sasi. Megjithatë pretendimi i parashtruesit është pjesërisht i bazuar pasi që paramasa e hartuar si e tillë nga njësia kërkuese gabimisht nuk ka përcaktuar sasinë për të cilin tenderuesit duhet të ofertojnë çmimet e tyre. Pra parimisht gabimi qëndron në paramasë dhe jo në çmimet që kanë ofertuar jo vetëm tenderuesi i rekomanduar por edhe tenderuesit e tjerë. Kjo pasi që nuk ka mundësi që të ofrohet çmimi për diçka që nuk i dihet sasia. Kuptohet se çmimi për një punë ose produkt përcaktohet në bazë të sasisë së kërkuar. Në rastin konkret në paramasë njësia kërkuese gabimisht nuk e ka përcaktuar fare sasinë përkatëse.**

Me rastin e rivlerësimit komisioni duhet të konfirmoj nëse ekzistojnë gabime në paramasën e publikuar në sistemin e-prokurimi lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Nëse komisioni rivlerësues e konfirmon se ekzistojnë gabimet në paramasë të potencuara më sipër, atëherë komisioni rivlerësues duhet të shqyrtoj nëse këto gabime përbëjnë arsye për anulimin e aktivitetit të prokurimit me qëllimin që të përmisohen gabimet e evidentuara në paramasë dhe të rishpalljes më pastaj. Me këtë rast komisioni për rivlerësim duhet të ketë parasysh nenin 62 paragrafin 1 nënparagrafin 1 të LPP ku përcaktohet se Autoriteti kontraktues mund të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënie të kontratës nëse ka ndodhur *“një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit...”*.

Po ashtu duhet cituar edhe nenin 43 paragrafin 43.5 nënparagrafët i) të RRPP ku përcaktohet se procedura e prokurimit duhet të anulohet pas hapjes së ofertave nëse “një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi”. Në rastin konkret shkeljet e ligjit të cilave ju referohen dispozitat e cituara më sipër mund të jenë të ndërlidhura me nenin 27 dhe 28 lidhur me nenin 1, 6 dhe 7 të LPP si dhe nenin 10 paragrafin 10.1 nënparagrafin b lidhur me nenin 11 paragrafin 11.1 nënparagrafin f të RRPP. Konkretisht gabimet e evidentuara në paramasë si të tilla mund të bëjnë që paramasa të mos jetë në përputhje me standardet e përcaktuara nga LPP dhe RRPP pasi që në mungesë të sasive të përcaktuara në rubrikën 4.6 dhe 4.7 mund të pamundësojnë që tenderuesit të ofertojnë me çmime adekuate dhe rrjedhimisht e pamundësojnë që vlerësimi i tenderëve të bëhet i drejtë dhe në përputhje me parimet për mos diskriminim/favorizim, ekonomikitet dhe efikasitet. Sidoqoftë, për arsyet e elaboruara më sipër është gjetur se ky pretendim i parashtruesit është pjesërisht i bazuar.

Sa i përket pikës tjetër të pretendimeve ankimore sipas të cilave tenderuesi i rekomanduar është i dënuar me vendim të gjykatës, komisioni për rivlerësim mund të kërkoj sqarime shitesë duke u bazuar në nenin 72 të LPP lidhur me nenin 38 të RRPP. Në këtë mënyrë komisioni për rivlerësim mund të vlerësoj nëse tenderuesi në fjalë i plotëson kriteret e pranueshmërisë sipas nenit 65 të LPP në kuptim të pretendimit ankimor.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Për këto arsye është miratuar si e bazuar pjesërisht kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Për pikën I, I dhe III të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1 të RRPP. Për pikën IV dhe pikën V të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 14.08.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.